



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS SPANJOLLE



PROGRAMI I LËNDËS
Qytetërimi i Amerikës Latine 2

Ngarkesa: 4 kredite; 40 orë mësimore; 20 leksione / 20 seminare

Viti / Semestri : Viti i III , semestri I

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Bachelor në Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Hispanik

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: Studenti do të mësojë të njohë proceset historike; lidhjen mes fakteve politike, ekonomike, sociale dhe kulturore të historisë si dhe rolin që kanë luajtur individë të vecantë; analizojë dhe të formojë një gjykim personal , të arsyeshëm dhe aktiv mbi fenomenet e ndryshme historike.

Objektivat specifike lëndore:

Studenti duhet të:

1. Analizojë në mënyrë kritike proceset historike që kanë ndodhur në Amerikën Latine gjatë periudhës postkoloniale, historisë Moderne dhe Bashkëkohore.
2. Të zhvillojë aftësitë gjuhësore: aftësia për të komunikuar me gojë dhe me shkrim si dhe njohja e terminologjisë bazë të periudhës në fjalë.
3. Aftësitë dixhitale: Aftësia për të kërkuar dhe administruar informacionin në internet si dhe për të bërë komente e për të prezantuar projekte
4. Aftësitë shoqërore dhe qytetare: nxitja e punës në grup dhe sensibilizimi për temat sociale.
5. Aftësitë ndërkulturore: Aftësia për të njohur proceset historike politike dhe sociale dhe të diversitetit kulturor.